

AKT THEMELIMI
i
Shoqërisë Tregtare "NIEM" SHPK
(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)



Sot në datë 13. 02. 2004 ne themeluesit :

1. z. Armandi Kambo, i biri i Bariqit, i dt.lindjes 18.05.1975, shtetas shqiptar, lindur në Bitinckë, banues në Bitinckë - Bilisht, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0728720 dhe,
2. z. Thanas Beqirllari, i biri i Hakiut, i dt.lindjes 03.06.1953, shtetas shqiptar, lindur në Kuç i Zi, banues në Kuç i Zi - Korçë, mbajtës i pasaportës me Nr. 1861447

mbështetur në Ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqërite Tregtare" vendosëm të zhvillojmë veprimtari ekonomike private duke destinuar pasuri tona personale në formën e një shoqërie tregtare të organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 1

Themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të mbajë emërtimin **"NIEM" SHPK**

NENI 2

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e lartpërmendur është Person Juridik me seli në Bitinckë - Bilisht.

Me vendim Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë, filiale ose përfaqësi, apo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri të dyte apo kontrolluese në një shoqëri tjetër në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 3

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Zbatim i punimeve të ndërtimit :

Kat. 1 - Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj

Kat. 2 - Prodhim të materialeve të ndërtimit : inerte, rere, çakull, mermer.

Elemente të parafabrikuar, betoni e b/armeje, të pararendur dhe Armocementi.

Prodhime druri, metalike, plastike, etj. për dyer, dritare, kallëpe etj.

Kat. 3 - Ndërtime civile, ushtarake dhe ekonomike

Kat. 4/a - Ndërtim rruge kat. V, IV.

4/b - Ndërtim rruge kat. III, II, I.

4/c - veshje me asfaltobeton të rrugëve (ndërtim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe.

Kat. 6/a - Ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore deri 10 m.

Kat. 8 b - Ndërtim ujësjellsa dhe kanalizime

C - Ndërtime vepra kullimi, ujitje toke e impjante vaditëse.

G - Punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik.

Kat. 10/a - rikonstruksione godinash civile, ushtarake e ekonomike, veshje fasadash etj.

Kat. 14/d - Mirëmbajtje dhe zhvillimi i dekorit në mjediset urbane.

Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim të materialeve të ndryshme për ndërtime si dhe shërbime të lidhura me aktivitetin e ndërtimit të objekteve të karakterit publik e privat, industrial, bujqësor, tregtar, ushqimor, të shërbimeve etj,

Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim i artikujve të ndryshëm industrialë, konfeksione, paisjeve elektro-shtëpijake, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, kancelarie - shkollore, i artikujve ushqimorë, medikamenteve, paisjeve mjeksore, etj.

Import - Eksport, transport, tregëtim të produkteve bujqësore e blegtorale, fruta - perime, produkte të detit, bimë medicinale, eterovajore, prodhime kozmetike, detergjentë etj.

Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, baresh, restorantesh, diskoteka, qendra pushimi e kurative.

Autoservis për automjete të kategorive të ndryshme, për traktorë , autokombanja si dhe tregëtim të pjesëve të tyre , tregëtim me pakicë të karburantit e nënprodukteve të tij.

Import-eksport, transport, prodhim, tregëtim për të tretët me materialin e vet ose të porositësit.(Fason)

NENI 4

Për plotësimin e objektit të saj shoqëria mund të realizojë lidhjen e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

NENI 5

Objekti, veprimtaria e kesaj shoqërie me pergjegjesi te kufizuar, organizimi si dhe marrëdhëniet e saj ne qarkullimin civil me shtetas shqiptare apo te huaj, me persona juridike private e publike vendas apo te huaj percaktohen ne statutin e shoqerise dhe rregullohen nga legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise.

NENI 6

Shoqëria tregtare **"NIEM" SHPK** do te filloje veprimtarine e vet tregtare me një kapital themeltar prej 100.000 lek.

Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërise tregtare **"NIEM" SHPK** përbëhet nga kontributet e mëposhtme :

1. z. Armandi Kambo kontribuon me 50.000 lekë duke zotëruar 50 % të kapitalit themeltar

2. z. Thanas Beqirllari me 50.000 lekë duke zotëruar 50 % të kapitalit themeltar
Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në 100

Në bazë të kontributeve të lartpërmendura :

z. Armandi Kambo, zotëron 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 50.

z. Thanas Beqirllari, zotëron 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 51 deri në numrin e serisë 100.

Pjeset e kapitali themeltar të shoqërise janë tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga ortakët.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar **"NIEM" SHPK** sipas nenit 6 të këtij akti përfaqëson kapitalin për themelimin e shoqërisë tregtare.

Kapitali i nevojshem per veprimtarine ekonomike e tregtare te kesaj shoqerice do te trajtohet si kapital investues.

NENI 8

Shoqëria tregtare **"NIEM" SHPK** fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Gjykatën e Shkalles Pare Tirane.

Shoqëria tregtare **"NIEM" SHPK** gëzon personalitet juridik shqiptar



NENI 9

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj me afat të papërcaktuar.

NENI 10

Në mbështetje të Ligjes "Per Kontabilitetin" pasqyrohet fondi themeltar ku shënohen kapitalet e vëna prej ortakëve në bazë të nenit 6 të këtij Akti
Fondet në investime nënshkruhen në raport me vlerën e tyre dhe do t'i përgjigjen fazës së aktivitetit sipas vendimit të Asamblesë dhe legjislacionit

NENI 11

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e veta me fondet e saj.

NENI 12

Të drejtat e detyrimet e ortakëve themelues:

të shlyeje kapitalin themeltar të shoqërisë për pjesën takuese sipas nenit 6 të Aktit të Themelimit,

të marrë pjesë në drejtimin e kësaj shoqërie

të marrë pjesë në ndarjen e fitimit të shoqërisë në përputhje me statutin e saj

të marrë pjesën perkatese në pasurinë e shoqërisë me pushimin e aktivitetit

te saj

te përgjigjet për detyrimet e shoqërisë në kufijt e kapitalit të investuar në këtë shoqëri.

të veprojë me inisiativë për realizimin e sukseshëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas përcaktimeve të bëra në statut

NENI 13

Ortakët themelues do të ndajnë fitimin, në raport me pjesët zotëruese në kapitalin themeltar, që do të rezultojë nga aktiviteti i shoqërisë tregtare, pas likuidimit të taksave dhe tatimeve e gjithë shpenzimeve të tjera.

NENI 14

Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie tregtare, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e një kontrate të vecantë në të cilën do të përcaktohen të drejtat e detyrimet ligjore të secilës pale si dhe paga mujore në mbështetje të legjislacionit shqiptar që rregullon marrëdhëniet e punës.

NENI 15

Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë tregtare do të bëhet sipas statutit të saj mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 16

Për mosmarrëveshjet që nuk do të mund të zgjidhen me mirekuptim kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës Parë Tiranë.

NENI 17

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) ekzemplare origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

Ortakët Themelues

Thanas Beqirllari

Thanas Beqirllari



Armandi Kambo

Armandi Kambo



G - Punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik.

Kat. 10/a - rikonstruksione godinash civile, ushtarake e ekonomike, veshje fasadash etj.

Kat. 14/d - Mirëmbajtje dhe zhvillimi i dekorit në mjediset urbane.

Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim të materialeve të ndryshme për ndërtime si dhe shërbime të lidhura me aktivitetin e ndërtimit të objekteve të karakterit publik e privat, industrial, bujqësor, tregtar, ushqimor, të shërbimeve etj,

Import - Eksport, prodhim, transport, tregëtim i artikujve të ndryshëm industrialë, konfeksione, paisjeve elektro-shtëpijake, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, kancelarie - shkollore, i artikujve ushqimorë, medikamenteve, paisjeve mjeksore, etj.

Import - Eksport, transport, tregëtim të produkteve bujqësore e blegtorale, fruta - perime, produkte të detit, bimë medicinale, eterovajore, prodhime kozmetike, detergjentë etj.

Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, baresh, restaurantesh, diskoteka, qendra pushimi e kurative.

Autoservis për automjete të kategorive të ndryshme, për traktorë , autokompanja si dhe tregëtim të pjesëve të tyre , tregëtim me pakicë të karburantit e nënprodukteve të tij.

Import-eksport, transport, prodhim, tregëtim për të tretët me materialin e vet ose të porositësit.(Fason)

NENI 6

Për plotësimin e objektit të saj shoqëria mund të realizojë lidhjen e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë publik apo privat, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

NENI 7

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Shkalles Pare Tirane ne Regjistrin Tregtar prane kesaj Gjykate.

Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të shoqërisë tregtare nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.

NENI 8

Kohëzgjatja

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK do te permbushe objektin e veprimtarise se vet me nje afat te pacaktuar.

NENI 9

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare apo industriale qe secili ortak zhvillon ne menyre te pavarur prej saj.

Ortakët e shoqërisë marrin persiper te paguajne pjeset qe u takojne nga humbjet e aktivitetit tregetar ne kete shoqeri

NENI 10

Kapitali

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK do te filloje veprimtarine e vet tregtare me nje kapital themeltar prej 100.000 lek.

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise tregtare "NIEM" SHPK përbëhet nga kontributet e mëposhtme :

1. z. Armandi Kambo, kontribuon me 50.000 lekë duke zotëruar 50 % të kapitalit themeltar
2. z. Thanas Beqirllari, kontribuon me 50.000 lekë duke zotëruar 50 % të kapitalit themeltar

NENI 11

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100

Në bazë të kontributeve të lartpërmendura :

1. z. Armandi Kambo, ka 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 50.

2. z. Thanas Beqirllari, ka 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 51 deri në numrin e serisë 100.

Pjesët e kapitali themeltar të shoqërise janë tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga ortakët.

NENI 12

Në bazë të kapitalit themeltar të shoqërise tregtare fitimi do të ndahet në menyrë të përfaktuar nga Ligja dhe në Nenet 6 e 13 të Aktit të Themelimit.

NENI 13

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

NENI 14

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kesaj shoqërie tregtare megjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar behen të transferueshme.

NENI 15

Në rast mos pranimit pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e shumicës që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar ose shihet mundësia e blerjes së tyre nga shoqëria.

NENI 16

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve të kesaj shoqërie tregtare.

NENI 17

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar me anë të kontributeve me para dhe në natyrë bëhet me miratimin e Asamblesë së Ortakëve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar dhe me kërkesën qoftë edhe të njerit prej ortakëve.

KREU I DYTE

Ortakëria

NENI 18

Ortakëria për shoqërine tregtare "NIEM" SHPK krijohet dhe mbështet në Aktin e Themelimit të kesaj shoqërie dhe në Ligj.

NENI 19

Votat e ortakëve kanë vlerë proporcionale me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Cdo kuotë ka të drejtën e një vote.

Ortakëri mund të përfaqësohet në Asamble nëpërmjet një ortakëri tjetër ose nëpërmjet një përfaqësuesi, duke u pajisur këta me prokurë të posaçme dhe të marrin vendime për ato çështje që diskutohen në mbledhjen për të cilën kanë marrë të drejtën e përfaqësimit.

Ortakëri në këtë shoqëri tregtare nuk mund të ngarkojë një mandatmbajtës të votoje në emër të një pjesë të kapitalit të tij themeltar duke votuar ai vetë në emër të pjesës tjetër të kapitalit të tij themeltar.

NENI 20

Ortakëri i shoqërise tregtare "NIEM" SHPK gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 21

Cdo Ortakëri merr pjesë për plotësimin e suksesshem të objektit të kesaj shoqërie tregtare, të vete në dispozicion aftësitë e tij tekniko-organizative si dhe të ndjeke vijueshmërinë e shoqërise personalisht apo edhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor sipas rregullave të këtij Statuti

KREU I TRETE
Organizimi i shoqërisë tregtare

NENI 22

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK ka si struktura drejtuese :

Asamblesë e Ortakëve

Administratorin.

Asambleja me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të krijojë organe administrative të karakterit teknik.

Shoqëria tregtare me miratim të Asamblesë së Ortakëve vendos dhe emërtime honorifike.

NENI 23

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.

Në përbërje të saj përfshihen ortakët e shoqërisë, pamvarësisht nga pjesa zotëruese në kapitalin e shoqërisë.

Asambleja e ortakëve thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose nga ortakët të cilët zoterojnë të pakten 1/10 e kapitalit themelitar të shoqërisë

Asambleja e ortakëve të shoqërisë tregtare "NIEM" SHPK. thirret të pakten një herë në vit.

Lajmerimi bëhet me leter rekomande ose me telegram me lajmerim marrje të pakten 15 dite para mbledhjes së Asamblesë. Lajmerimi, si rregull, duhet të bëhet nga Administratori dhe duhet të përmbajë rendin e ditës.

Mospjesëmarrja e ortakut të lajmeruar duhet të pasohet me njoftimin urgjent të shkaqeve të mosparaqitjes dhe njoftimin e administratorit për datën e mundshme të paraqitjes. Me këtë rast duhet të respektohet afati i përcaktuar në paragrafin e pestë të këtij neni.

Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme e ortakut të thirrur përben shkelje të rëndë të detyrave të ortakut të përcaktuara në Aktin e Themelimit

Vendimet e saj sipas karakterit dhe rëndësisë merren me shumicë të zakonshme, shumicë absolute, me shumicë me të lartë se $\frac{3}{4}$, në bazë të kriterit të shumicës së dyfishtë apo me unanimitet.

Çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 24

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve:

- Vendos për politikën afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj
- Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut
- Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
- Të vendosë për zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themelitar të shoqërisë
- Të emerojë dhe shkarkojë Administratorin e shoqërisë
- Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë
- Të shprehë për kohezigjatjen e shoqërisë
- Të miratojë marrëveshjet arritura në qarkullimin civil të saj
- Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.
- Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit dhe Statutit të shoqërisë.

Proces verbalët e mbledhjeve ruhen në seline të shoqërisë

NENI 25


Administrimi i shoqërisë "NIEM" SHPK kryhet nga Administratori/rët i/të emëruar nga Asambleja. Administratori/ Administratorët mund të jenë persona fizikë jashtë shoqërisë ose dhe nga ortakët.

Administratorët e parë të emëruar nga Asambleja themeluese janë z. Armandi Kambo dhe z. Thanas Beqirllari

NENI 26

Kompetencat e administratorit/rëve janë :

- Të mbikqyrë dhe të kontrollojë gjithë veprimtarinë e shoqërisë





- Të vendosë për problemet që i lindin shoqërisë në periudhën midis dy mbledhjeve të Asamblesë në zbatim të detyrave të saj
 - Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, në administratën publike e në organet gjyqësore
 - Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregëtar e ekonomik
 - Të paraqes për miratim Asamblese së Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe te përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punes i Republikës së Shqipërisë.
- Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë
- Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar
- Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Asambleja
 - Të informojë me shkrim ortakët për çdo problem që i kerkohet prej tyre në konformitet me ligjin
 - Të hartojë planet e llogarive ekonomike e ti paraqes ato per miratim në asamble
 - T'û pergjigjet me shkrim kerkesave te se njejtës natyre te bera nga ortakët
 - Si dhe çdo detyrë të njohur e të përcaktuar në ligj
 - Ata, veçmas njeri - tjetrit, mund të ushtrojnë kompetencat e parashikuara në këtë nen dhe në ligj, duke ruajtur secili të drejtën të mos kundërshtohet për çdo operacion, para se ky të ketë përfunduar.

NENI 27

Administratorët janë përgjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te legjislacionit, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

NENI 28

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK emerion eksperte kontabel te autorizuar. Emerimi kryhet nga Asambleja me unanimitet të ortakëve. Per kompetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendeshueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e ekspertit kontabel te autorizuar zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 29

Aktiviteti financiar i shoqërisë do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci, llogaritë vjetore, do te miratohet/en brenda tre muajve te vitit ne vazhdim. Perjashtimisht nga kjo, viti i parë financiar fillon ditën e regjistrimit të shoqërisë si person juridik

NENI 30

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fondet e tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik, tregëtar, për krijimin e valutes etj. Përbërja e kapitalit te shoqërisë, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i çdo fondi te veçante percaktohen nga organi administrativ sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut. Te ardhurat e pergjithshme te shoqërisë dhe ne pergjithesi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbështetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga Asambleja e Ortakëve do te shpërndahen si vijon : 5 % për fondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar; pjesa tjetër ndahet midis ortakëve te kesaj shoqërie ne raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

NENI 31

Pasurite e shoqërisë vleresohen ne Monedhe shqiptare.

Shoqëria tregtare "NIEM" SHPK eshte pronare e pasurise se saj, te cilen e perdor dhe e disponon ate ne emer te saj ne perputhje me qellim dhe objektin e veprimtarise se

Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

KREU I KATERT

Bashkimi dhe ndarja e shoqerise

NENI 32

Shoqeria tregtare "NIEM" SHPK me ane te bashkimit mund t'i kaloje trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojne.

Gjithashtu me ane te ndarjes ajo mund t'i kaloje trashëgimine e saj disa shoqerive te reja ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

NENI 33

Ne rast se operacioni perfshin krijimin e shoqerive te reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave qe i perkasin formes se shoqerise qe do te krijohet.

NENI 34

Transferimi i plote i aktivitet te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerie tjeter, vecanerisht me ane te procesit te bashkimit duhet te autorizohet me pelqimin unanim të ortakëve.

KREU I PESTE

Prishja dhe Likuidimi i shoqerise

NENI 35

Shoqeria tregtare "NIEM" SHPK priset kur:

- Ortakët nuk respektojnë te drejtat e detyrimet e percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut.
- Veprimtaria e shoqerise perben shkelje te renda te aktit te themelimit, te statutit e të ligjit.
- Kur Asambleja e Ortakëve refuzon marrjen e vendimeve të domosdoshme për ecurinë e shoqërisë në përputhje me objektin e saj dhe rregullat e percaktuara në Statut e në ligj mbas dy lajmerimeve radhazi dhe çmohet pamundësia e permbushjes se objektit te shoqerise
- Shoqeria nuk priset kur vdes një prej ortakëve
- Shoqeria nuk priset kur falimenton ose shfaq paaftesi një prej ortakëve.
- Shoqeria priset me vendim te Gjykates

NENI 36

Likuidimi i shoqerise tregtare "NIEM" SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakëve kur:

- plotesohet qellimi per te cilin eshte krijuar kjo shoqeri tregtare
- kur priset shoqeria
- me vendim të Gjykatës

NENI 37

Ne këtë rast nga Asambleja e Ortakëve caktohet nje ose disa likujdues te cilit/cilëve i/u ngarkohet ne menyre te specifikuar detyra per menyren e likujdimit.

Kur Asambleja e Ortakëve nuk formon quoriumin e duhur për të vendosur prishjen e shoqërisë si dhe për caktimin e likujduesit/sve marrja e vendimit dhe caktimi i tyre, me kerkesen e Administratorit ose çdo personi të interesuar, bëhet nga Gjykata. Kerkesa duhet te permbaje dokumentacionin e parashikuar ne statut dhe ne Ligjin per Shoqerite tregtare.

NENI 38

Asambleja e Ortakëve thirret ne fund te procesit te likujdimit qe te vendose per bilancin financiar perfundimtar.

Ne qofte se Asambleja nuk mund te marre vendim ose ne qofte se nuk pranon te miratoje llogarite e likujduesit vendimi merret nga Gjykata me kerkesen e likujduesit ose te cdo personi te interesuar.

Dispozita të fundit

NENI 39

Te gjitha mosmarreveshjeve e mundshme zgjidhen me mirekuptim.

Ne rastet kur mosmarreveshjet nuk mund te zgjidhen me mirekuptim apo ne rruge administrative kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Shkalles Pare Korçë

NENI 40

Te gjitha personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie tregtare, punesimi i tyre do te behet mbi bazë kontrate në të cilën do te përcaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar ne kete fushe.

NENI 41

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Për Shoqëritë Tregtare si dhe legjislacioni përkatës që i përgjigjet objektivit të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 42

Ky statut perpilohet ne 4 (kater) ekzemplare origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtat vlera ligjore dhe nënshkruhet nga ortakët më datë 13.02.2004

Ortakë themelues

Thanas Beqirllari

Armandi Kambo

Thanas Beqirllari

Armandi Kambo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANË

Nr. 687 Rep.

Nr. 159 Kol.

VËRTETIM



Sot, më 13.02.2004, ditën e Premte, para meje noterit Robert Kolë, anëtar i Dhomes se Notereve Tiranë, u paraqitën personalisht : **1.** z. Armandi Kambo, i biri i Bariqit, i dt.lindjes 18.05.1975, shtetas shqiptar, lindur në Bitinckë, banues në Bitinckë - Bilisht, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0728720 dhe, **2.** z. Thanas Beqirllari, i biri i Hakiut, i dt.lindjes 03.06.1953, shtetas shqiptar, lindur në Kuç i Zi, banues në Kuç i Zi - Korçë, mbajtës i pasaportës me Nr. 1861447, të dy personat madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë tregtare **"NIEM" SHPK** më deklaruan se jashtë kësaj zyre është marrë dhe përpiluar me vullnetin e tyre të lirë e të plotë **Statuti i shoqërisë**, të cilin ata e nënshkruajnë atë përpara meje dhe unë noterit sipas ligjit vërtetoj nënshkrimet e tyre.

NOTERI

Robert Kolë

